



УТ - Факултет Филологиј - Република Северна Македонија
УТ - Филолошки Факултет - Република Северна Македонија
Nr.-Bp. 18-574/A
18.06.2026 vit/rod.
Tetovë - Tetovo

UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Në përputhje me Ligjin për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/18), Statutin e Universitetit të Tetovës, Statutin e Fakultetit Filologjik, dhe Udhëzuesin me kriteret për realizimin e zgjedhjeve për anëtarët dhe për kryetarin e Kuvendit Studentor të Fakultetit Filologjik, shpallet:

KONKURS

për paraqitjen e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve dhe të kryetarit të Kuvendit Studentor të Fakultetit Filologjik në Universitetin e Tetovës

I. Të drejtë për të aplikuar kanë të gjithë studentët që e kanë regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2025/2026, duke përfshirë edhe studentët që kanë regjistruar semestër veror të zbrazët në vitin akademik të lartpërmendur.

II. Së bashku me Fletaplikimin (formularin), kandidatët dorëzojnë:

- biografi (CV),
- vërtetim nga shërbimi për çështje studentore se kandidati e ka regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2025/2026,
- vërtetim për notë mesatare prej së paku 8 për kandidatin për kryetar, i cili do të zgjidhet në mbledhjen e parë të Kuvendit Studentor të Fakultetit.

III. Kandidatët për zgjedhjen e anëtarëve dhe të kryetarit të Kuvendit Studentor të Fakultetit janë të detyruar që personalisht t'i dorëzojnë fletaplikimet me dokumentet përkatëse, përmes arkivit të Fakultetit ose me postë në adresën: **Universiteti i Tetovës rr. “Ilindeninit”, p.n., 1200, Tetovë**, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve nga shpallja e njoftimit, respektivisht më së voni deri më **26.06.2026** në ora 16:30.

IV. Aplikimet e vonuara dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Kryetar i Komisionit Zgjedhor

Doc. dr. Lindita SKENDERI

